

27.10.2020

## STATUTI

I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

“ Construction Technique ”

#### KREU I

#### HYRJE

Neni 1

Shoqeria me përgjegjësi të kufizuara “Construction Technique” sh.p.k është themeluar nga ortaket:

**Massimiliano Mazzoli**, i biri i Giuseppe,\* me datëlindje 08.04.1967, lindur në Fabriano (AN),Itali dhe banues në Fabriano (AN),rruga Fraz.Moscano N.34,i identifikuar me nr personal Id AX2807403;

Themeluesit, të cilët janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin “ Për Tregtaret dhe shoqëritë tregtare” hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

#### KREU II

#### PERKUFIZIME

Neni 2

Emertimi i shoqërise

Emertimi i shoqërisë është “Construction Technique ”

Neni 3

Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shoqërisë, vecanërisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statute. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qëndrën Kombetare të Regjistrimit. Gjithashtu shoqëria e bazon aktivitetin e saj në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurencës” të ndryshuar, në Kodin Civil dhe Kodin e Punës si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 4**

#### **Forma**

Shoqëria "Construction Technique " sh.p.k është "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara"

#### **Neni 5**

#### **Selia**

1. Selia e Shoqërisë do të jetë Tiranë ,Kashar,Rr Ismail Qemali,Pallati Premvis,Shkalla B1,Kati I parë.
2. Shoqëria ka të drejtë të hapi filial të tjera brënda territorit të Republikë së Shqipërisë në varësi të selisë qëndrore që ndodhet në rrëthin e Tiranës.
3. Vendi I mbajtjes së asamblesë së përgjithshme është selia e shoqërisë. Nëse bihet dakort me unanimitet, mbledhja e asamblesë mund të kryhet në një vënd tjeter.

#### **Neni 6**

#### **Objekti i Veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jëtë:

1. Servis per montimin e impianteve industriale,Konsulencë ne sektorin elektro mekanik,konsulencë ne sektorin elektro industrial.  
(veprimataria e biznesit do te nderohet ne varesi te objektivave te kompanise)

#### **Neni 7**

#### **Vula e shoqërisë**

1. Shoqëria ka vulën e saj, në brëndësi të së cilës shkruhet I plotë emërtimi dhe forma e saj juridike.
2. Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulën e shoqërisë.

#### **Neni 8**

#### **Kohezgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jëtë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

## Neni 9

### Veprimet e lejuara të shoqërisë

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimitarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë asambleja e Përgjithshme me shumicen e ortakeve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit.

## Neni 10

### Marredhenia e punës

1. Shoqëria për të kryer veprimtarinë s saj sipas objektit të këtij statute do të lidhë kontrata individuale për të rregulluar marredheniet e punës.
2. Kontratat e punës do të lidhen konform ligjit " Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" dhe dispozitave të tjera ligjore që rregullojnë marredheniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

## KREU III

### PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

## Neni 11

### Ndalimi, konflikti i interest dhe personat e lidhur

1. Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyje në marredhenie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e interest të tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej te gjithë ortakeve ose të gjithë ortakëve të tjerë.
2. Cdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qëndrën Kombëtarë të Regjistrimit.
3. Miratimi i parashikuar jepet, gjithashtu, për cdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me palë të treatë, e cila ka marredhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqërine, apo me palë të tjera, marrëdhënet e të cilave me personat e mësipër janë të lidhur që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundershtim me interest e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interest e

mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqerinë:

- a. a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motra e bashkëshortit/bashkëshortes;
  - b. b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
  - c. c) personat e lidhur me personelin e autorizuar për të përfaqësur ose për të mbikëqyrur shoqerinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit ose të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërti i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
  - d. d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqerinë.
4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorume.
  5. Cdo veprim që kërkon miratim, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interest të personave të përfshirë.
  6. Për efekt të këtij statute, me persona të autorizuara për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqerinë tregtare do të kuptojmë ortakët e shoqërise, administratorin, ekspertin kontabël të autorizuar dhe likujduesin e shoqërisë.

#### **Neni 12** **Parimi I Besnikërisë**

1. Gjat ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marre parasysh interest e shoqërisë dhe të ortakëve të tjërë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjose nga ky satut, në rrethana të tjera, ortakët gjëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

#### **Neni 13**

##### **Ndalimi I Konkurencës**

1. Personat e autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqerinë tregtare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektorë ekonomik me shoqerinë e pare. Gjithashtu,

këta persona nuk mund të mbajnë satusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sector.

2. Ndalimi I përmëndur në pikën 1 të këtij nenit të shfuqizuar nëpërmjet një autorizimi të posacem, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.
3. Ndalimi I përmendur në pikën 1 të këtij nenit, të mbetur në fuqi edhe pas humbjes së cilësisë apo statutit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmëndur në pikën 1 të këtij nenit shkel ndalimin e konkurencës, shoqëria mund:
  - a) ta përsashtoje atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerje të veprimtarisë konkureuese;
  - c) të ngrejë paq i për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t’l kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij nenit:
  - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - b) t’l transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të trëtë.
  - c) t’l transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të trëtë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brënda tre viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmëndur zbatohen, gjithashu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit “ Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

#### Kreu IV

##### KAPITALI THEMALTAR – PJESMARRJA

1. Kapitali I shoqërise ka vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) liri ndahet në 1 kuota.
2. Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali I shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi I kapitalit I prekë të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të

kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogelohet nën kufirin minimal që lejon ligji " Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 15 Kontributet**

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortaku i shoqërisë, Massimiliano Mazzoli si vijon: Ortaku **Massimiliano Mazzoli** zotëron 100 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlerë prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Vlera e kapitalit themeltar të shoqerisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

#### **Neni 16 Kalimi i kuotave të kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe të kalueshme në rrugë trashëgimie. Trashegimtari paraardhësi ose pasardhësi, bëken ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund tu kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendimë të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{1}{2}$  e pjesëve të kapitalit.
3. Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje tu behet ortakeve të tjera të shoqërisë. Kur ortakët që gjëzojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshime rreth cmimit të kuotave të ortakut që kërkon ti kaloj ato, mund ti drejtohet gjykatës që të caktoj një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave te të tretët duhet te lajmërohet në një afat sa më të shpejtë, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk i jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjera kanë rën dakort që kuotat e tij mund ti kalojnë të tretëve.
4. Kalimi i kuotave do të bëhet me kontratë.
5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

#### **Neni 17**

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

**KREU V**  
**ORGANET E SHOQËRISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE**

**Neni 18**

**Asambleja e Përgjithshme**

1. Cdo ortakë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.
2. Ortaku mond të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër I zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë ( përjashtohet përfaqësimi I një ortaku nga një ortak tjetër apo administrator I shoqërisë).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jetë vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese në të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertët kontabël të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët , të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votive në Asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund ti drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e cështjeve të posacme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe cështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortake kane të drejtë ta thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe të caktojnë cështjen e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë ose nëpërmjet pastës elektonike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës t'u dergohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij nenii, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose cështja e kërkuar prej tyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që ka bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi " Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e përgjithshme merr vendime për cështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
  - a) Përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;

- c) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës).
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës);
  - h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) Cështje të tjëra të parashikuara nga ligji;
10. Të gjitha vendimet të marra nga Asambleja e Përgjithshme rregistrohen ne një regjistër të vendimeve, të dhëna të cilat nuk mund të ndryshohen apo të fshihen.
11. Duhen rrugjistuar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të Raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) Investime;
  - d) Vendime për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë automatikisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të zakonshme për cështje të tillë si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marre vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave dhe vendimet merren me me shumë se gjysma e votive të ortakëve pjesëmarrës.
15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar për cështje të tillë si ndryshimet e statutit, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likujdimi i saj, shndërrimi i shoqerisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimevetë vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojn më shumë se 50% e kuotave janë të pranishme, votojnë me shkresë apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e votive të ortakëve pjesëmarrës.

16. Në se asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në këtë pikë, të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 19 Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizikë të zgjedhur Brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emetimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi competent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Rëgjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

### **Neni 20 Kompetencat e administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarosë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) Krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) Krijojnë rregjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin Qëndrën Kombëtare të Rëgjistrimit;
  - g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme përsaparashikon ky statut ose ligji.

- Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumice të zakoshme.

#### **Neni 21**

##### **Emërimi i Parë I Administratorëve**

Administratori i shoqërisë për periudhën 5-vjecare emërohet ortaku Massimiliano Mazzoli.

#### **Neni 22**

##### **Ekspertë Kontabël të autorizuar**

- Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.
- Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emerimi i tij, në rast se vërtetohen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

#### **KREU VI**

##### **VOTA**

#### **Neni 23**

##### **E drejta e votës**

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote. Cdo ortak votat që ka mund ti japi vetëm në uniformitet.

#### **Neni 24**

##### **E drejta për të kaluar rezolutë**

Asambleja e përgjithshme munt të miratojë rezolutë pa plotësuar kriteret e njofteimit në këtë statut apo në ligj, Që të miratoket një rezolutë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të jenë të pranishme të gjithë ortakët personalisht dh eta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

#### **KREU VII**

##### **MARRËDHËNIET FINANCIARE**

#### **Neni 25**

##### **Viti Financiar**

Cdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

#### **Neni 26**

##### **Bilanci Vjetor**

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet financiare dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme.
2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhen brënda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.
3. Gjuha që përdoret në miratimin e dokumentave është gjuha shqipe.

#### **Neni 27**

##### **Dividentët**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividentëvë mbi fitimin në raport me kuatat që gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuotat, përbëhet nga fitimi i vitit finanziar të cilit i janë zbritur shumat e lena mënjanë përfondin reserve të domosdoshëm (5% e fitimit të cdo viti, deri sa ky fond të arrijëvlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 28**

##### **Marredhenia me bankat dhe institucionet financiare**

Shoqëria ka të drejtë të hap llogari likuisuese pranë një ose më shumë bankave ose institucioneve financiare dhe të kryejë veprime likujduese pranë bankave. Në këto banka ose institucione financiare si nënshkrim i parë do të depozitohet ai i administratorit të shoqërisë, i cili duhet të nënshkruaj përfundimisht gjitha veprimet financiare në emër e përllogatimit të shoqërisë. Ai mund të autorizojë edhe persona të tjera brënda shoqërisë.

#### **Neni 29**

##### **Marrëdhënia me organet tatimore.**

Veprimitaria ekonomike e shoqërisë mbaron më 31 dhjetor të cdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e të ardhurave, dhe ti dorzoj pranë organit përkatës të tatimeve.

#### **KREU VIII NDRYSHIMI I STATUTIT TË SHOQËRISË**

#### **Neni 30**

## **Prishja e shoqërisë**

1. Shoqëria prishet me perfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëvë falimenton, bëhet I paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kan mbetur si dhe me trashëgimtarin e radhës së parë të ortakut të vdekur.

### **Neni 31**

#### **Likujdimi**

1. Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likujdus, I cili I paraqet asaj raportin e likujdimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij.
2. Në fund të procesit të likujdimit asambleja vodos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullueshmërisë së punës së likijduesit dhe për mbylljen e procesit të likujdimit.
3. Pas pagimit të kreditorve dhe shlyerjes së kuotave tek kontribuesit përkatës, likijduesi ndan kapitalet e mbeturë ndërmjet ortakëve proporcionalishtme pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

### **Neni 32**

#### **Shndërrimi I shoqërisë**

Shndërrimi I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

#### **KREU IX**

#### **DISPOZITA TË TJERA**

### **Neni 33**

#### **Mosmarrveshjet**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit midis ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë.

### **Neni 34**

Për cështjet që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky Statut nënshkruhet nga themeluesi.

THEMELUESI I SHOQËRISË

Massimiliano Mazzoli

